



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

BURSA STUDIMI NË HUNGARI, VITI AKADEMIK 2017-2018

Në zbatim të programit të bashkëpunimit me Hungarinë në fushën e arsimit dhe shkencës, Qeveria e Republikës së Hungarisë, përmes **Fondacionit Publik Tempus**, shpall programin e bursave shtetërore për shtetasit e huaj, studentë dhe/ose lektorë të cilat përfshijnë kurset verore dhe qëndrimet kërkimore në fushën e kërkimit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë ose të Kërkimit të Hungarisë, për vitin akademik 2017-2018, sipas kategorive të ndara si më poshtë:

- ***Studime në fushën e kërkimit (3-29 ditë ose 1-10 muaj)***; Për qëndrime afatshkurtra (3 - 29 ditë) të gjithë të interesuarit duhet të jenë të pajisur të paktën me një diplomë të nivelit Master për të aplikuar. Për studime kërkimore afatgjata (1-10 muaj) mund të aplikojnë kandidatët të cilët kanë të paktën një diplomë master. Studentët që ndjekin studimet doktorale nuk mund të aplikojnë. Nuk ka limit moshe për aplikantët, mjafton që kandidatët të jenë mbi 18 vjeç në momentin e aplikimit. Studimet për të cilat është akorduar një bursë duhet të kryhen përgjatë vitit akademik 2017-2018 dhe duhet të përfundojnë maksimalisht brenda datës 30 qershor 2018.
- ***Kurse Vere (2-4 javë)***; thirrjet për aplikime për kurset e verës do të shpallen në Janar 2017. Informacione të detajuara për këto bursa do të gjenden pas kësaj periudhe në web-site: <http://tka.hu/international-programmes/4133/informaton-for-applicants>. Për kurset e verës nuk ka kufizim moshe.

Kandidatët, përmes aplikimit **online** duhet të bëjnë regjistrimin në web-site e Fondacionit publik Tempus www.scholarship.hu.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data **30 Janar 2017**.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve për kurset verore do të publikohet në vijim.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit referojuni materialeve informativë që gjenden në adresat web-site:

www.scholarship.hu;

<http://www.studyinhungary.hu>;

<http://tka.hu/international-programmes/4133/information-for-applicants>;

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE